

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

24/05/2024

Nr. i Protokollit: 02/ 681

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Reçak

E enjte, më 14 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 17:15 – 18:30

Vendi i takimit: SHF 'Skenderbeu'

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti, Drejtori i drejtorisë për Planifikim Urban Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emmini, Asambleistët – Besnik Seferi, Asllan Beqaj, Sanie Sadiku,

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Ne kemi filluar si institucion dëgjimet publike për buxhetin për vitin 2025, sot është dita e dytë dhe fshati i pest që jemi në Reçak, ne sot jemi këtu bashkarisht me Asamblesitë dhe Drejtorë që të marrim kërkesa në fshatin e juaj. Edhe në vitin e kaluar kemi qenë dhe kemi marr kërkesa prej banorëve, te gjitha ato kërkesa të cilat kanë qenë prej banorëve janë të buxhetuara për këtë vit, disa punime kanë filluar dhe disa të tjera pritet të fillojnë sepse janë në procedura të prokurimit, ndërsa sot do të fokusohemi më shumë për vitin 2025 që t'i shohim të gjithë kërkesat për çfarë ka nevojë fshati Reçak.

Fillimisht ju njoftoj që buxheti për vitin 2025 ka një rritje prej afro 1 milion euro, do të thot nga 10 milion shkon në 10 milion e 770 mij, ky është buxhet lokal pa i përfshirë investimet e tjera që vijnë nga niveli qendror. Ju e dini që ne këto vite përveç që e kemi pasur buxhetin lokal kemi thithur edhe shume fonde nga niveli qendror, shumë projekte të mëdha që i kanë ardhur Shtimes, mendojmë që edhe ne vitin 2025 do të ketë projekte të tjera të cilat do të vijnë në Shtime. Po punohet vazhdimisht që të mundohemi që ti dërgojmë përpara gjitha projektet që i kemi premtuar në fushatë por je vetëm në fushatë, sepse i kemi tejkaluar të gjitha ato të cilat i kemi premtuar.

Buxheti ndahet në disa kategori dhe pjesa më e madhe e këtij buxheti ndahet tek pagat dhe mëditjet, me vetë faktin që në vitin 2023 janë rritur pagat nga Qeveria Kurti është rritur edhe buxheti, mbi 50% e këtij buxheti shkon vetëm për pagat dhe mëditjet ndërsa 50% e buxhetit mallra dhe shërbime, investimet kapitale, subvencionet e kështu me rradhë.

Ne jemi sot këtu që t'i marrim kërkesat e juaja që t'i bëjmë pjesë të buxhetit për vitin 2025.

Kërkesat e banorëve të fshatit :


- Heset Rashiti: Ujë të pijes nuk kemi në fshatin Reçak. Emërtimi i një rruge dhe vendosja e numrave pasi që nuk kemi.
- Adem Ramadani: Sa i përket pjesës së ujit ku e tha edhe personi para meje, fshati është keq, rrjeti i ujësjellsit është në të gjithë fshatin mirëpo ujë nuk ka. Këtë çështje e kam ngritur edhe në asamble po ashtu kam bërë kërkesë edhe tek ujësjellsi, mirëpo përgjigjia e tyre ka qenë që për shkak të orëve të ujëmatësve në tre fshatra është ndërprer uji komplet. Së paku ju si Komunë duhet të bëni presion tek ujësjellsi që të bëhet një zgjidhje. Kërkesë tjetër është edhe rruga “28 Nëntori”, kanalizimi nuk është funksional për të gjitha shtëpit, po ashtu edhe ujërat atmosferike, nga shtëpit lart vijnë nëpër rrugë, prandaj do të ishte mirë që kjo gjë të rregullohet. Rivitalisimi i rrugës “William Woker”, kemi edhe një kërkesë ndërtimin e një ure në fshatin Reçak
- Nexhmedin Sylja: Nga Xhamia deri tek shtëpia e Minushit, kockat e trotuarit kanë rënë teposht, prandaj do të ishte mirë që të rregullohen. Të zgjerohet pjesa e “15 Janarit”, rruga ku ka mbetur e ngushtë.
- Minush Brahimi: Rruga nga Xhamia që shkon në Shtime nga Çesta, është ngushtuar, po ashtu në të njëjtën rrugë nevojitet edhe ndriçim. Po ashtu edhe urën të cilën më lart e përmendi Adem Ramadani, është mirë që kur të rregullohet ajo urë të bëhen edhe disa barriera.
Rruga “15 Janari”, tek pjesa në Komplexin rrjedh një ujë, a mundet aj ujë të ndalet. Po ashtu edhe dy gropa të mbulohen tek Kompleksi.
Rruga “Besa besë”, të rregullohet dhe ndriçimi tek “Ahmet Kaçiku” dhe rregullimi i trotuarit.
- Xhelal Ismajli: Për fshatin Reçak është i nevojshëm një park të rregullohet, mbrapa shkollës e kemi hapësirën ku ka mundësi të rregullohet aty. Njëkohësisht të rregullohet edhe rruga sepse është me shkallë sepse shkallët janë shumë të papërshtatshme edhe më pas nxënësit nuk kanë nevojë të udhëtojnë me kombi, pra në vend të shkallëve të rrafshohet. Është një rrugë e cila ka mbetur në gjysmë, ku ndodhen disa ara, prandaj nëse është mundësia të bëhet rrugë e arave dmth të shtrohet.
Vrella në fshatin Reçak të përdoret për ujitje.
- Nysret Zymeri: Trotuari në Çest të rregullohet sepse ka mbetur keq, po ashtu edhe fshati Reçak si fshatrat e tjerë ka nevojë për një park.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Reçak

Date: 14/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	ARMEND IMERI	Armeni
2	MINUSH BRAHIMI	Blini
3	ADEM RAMADANI	Rea -
4	HESET RASHITI	H. Rashit
5	AYDYL HISELI	Ajari
6	XHELAL ISMAJLI	Xhelal
7	ARSIM RAMA	Arasim
8	SKENDER BAJRAMI	Skender
9	MUHAMET BILALI	Muhamet
10	XHEHMEDEH SYDO	Xhehmedeh
11	MUHAMET DEDINI	Muhamet
12	HEPER XHELADIN	Heper
13	FAGREDA METUZI	Fagreda
14	SEBASTIAN YAKUPI SITUGA	Sebastian
15	i qort' e qort'	qort'
16	Shkëlz	
17	SKENDER DEDINI	Skender

18	Mubarez Garji asa D+	
19		
20		
21		
22		
23		
24		
25		
26		
27		
28		
29		
30		
31		
32		
33		
34		
35		
36		
37		
38		
39		
40		
41		